



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT
TEATRI KOMBËTAR EKSPERIMENTAL “KUJTIM SPAHIVOGLI”

PLANI I INTEGRITETIT TË TEATRIT KOMBËTAR EKSPERIMENTAL “KUJTIM SPAHIVOGLI”

2026-2030

Miratuar me Urdhrin Nr.04, Datë.09.01.2026 të Drejtorit të Teatrit Kombëtar
Eksperimental “Kujtim Spahivogli”

DEKLARATA E INTEGRITETIT INSTITUCIONAL

Plani i Integritetit i Teatrit Kombëtar Eksperimental “Kujtim Spahivogli”, institucion në varësi të Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit,) është një dokument strategjik i hartuar në përputhje me metodologjinë e vlerësimit të riskut të integritetit për institucionet publike, me synim parandalimin e korrupsionit, rritjen e transparencës dhe forcimin e llogaridhënies institucionale.

TKEKS, si institucion publik kulturor me mision artistik, edukativ dhe shoqëror, angazhohet të ushtrojë veprimtarinë e tij në përputhje me parimet e ligjshmërisë, paanshmërisë, profesionalizmit dhe etikës. Ky plan synon të identifikojë dhe adresojë risqet që mund të cenojnë integritetin institucional, veçanërisht në fushat e menaxhimit financiar, burimeve njerëzore, proceseve artistike, transparencës dhe marrëdhënieve me publikun dhe partnerët.

Zbatimi i Planit të Integritetit përfaqëson një angazhim të qartë të drejtimit dhe stafit të TKEKS për ndërtimin e një kulture organizative të bazuar në integritet, përgjegjësi dhe besim publik.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Gjergji Preyazi



**Grupi i Punës për hartimin e Planit të Integritetit në Teatrin Kombëtar Eksperimental
“Kujtim Spahivogli”,**

- | | |
|-------------------|--|
| 1. Ada Ruçi | Drejtor i Zhvillimit Artistik |
| 2. Alma Gjeta | Përgjegjës i sektorit të Financës |
| 3. Marsela Zeqaj | Specialist i Financës/Arkiv/Protokoll |
| 4. Mikela Gjolena | Specialist i Edukimit Përmes Kulturë/ Jurist |
| 5. Enkela Lika | Specialist i Edukimit Përmes Kulturës |
| 6. Silvi Vrap | Specialist Skene |

TABELA E PËRMBAJTJES

Plani i Integritetit

1.1. Procesi i zhvillimit të Planit të Integritetit

Procesi i hartimit të Planit të Integritetit në Teatrin Kombëtar Eksperimental “Kujti Spahivogli” konsistoi në zbatimin e fazave të mëposhtme:

1.1.1 Ngritja e grupit të punës për hartimin e Planit të Integritetit dhe mobilizimi i stafit të insitucionit.

1.1.2 Identifikimi dhe analiza e riskut

1.1.3 Vlerësimi i risqeve të integritetit

1.1.4 Plani i Veprimit për Menaxhimin e Riskut

1.2. Qasja metodologjike

1.3. Përmbajtja e Planit të Integritetit

I. RISQET DHE FAKTORËT E RISQEVE TË INTEGRITETIT

1.1 Risqe dhe faktorë të risqeve të lidhura me mjedisin e brendshëm rregullator dhe institucional për integritetin dhe luftën kundër korrupsionit.

1.2 Risqe dhe faktorët e risqeve të lidhura me burimet njerëzore në institucion (burime njerëzore adekuate, të qëndrueshme, të kualifikuara dhe me trajnime të përshtatshme)

1.3 Risqe dhe faktorët e risqeve për transparencën e punës dhe e veprimtarisë së TKEKS brenda institucionit, me aktorë e jashtëm të interesuar dhe publikun

II. PLANI I VEPRIMI

2.1 Monitorimi dhe raportimi i Planit të Veprimit

PLANI I INTEGRITETIT

Teatri Kombëtar Eksperimental “Kujtim Spahivogli”

Plani i Integritetit për Teatrin Kombëtar Eksperimental “Kujtim Spahivogli” (TKEKS) u hartua gjatë periudhës **Dhjetor- Janar 2026**, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe politikat shtetërore për parandalimin e korrupsionit dhe forcimin e integritetit në institucionet publike, si dhe në zbatim të udhëzimeve të Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit.

Qëllimi i Planit të Integritetit të institucionit është:

- i) vlerësimi i risqeve të integritetit që mund të komprometojnë aftësinë e TKEKS për të ushtruar funksionin e shërbimit publik në mënyrë të paanshme, transparente dhe të përgjegjshme, si dhe identifikimi i faktorëve që mund të mbështesin ose rrisin këto risqe;
- ii) formulimi i masave të përshtatshme për parandalimin, reduktimin ose eliminimin e risqeve të identifikuara.

1.1 Procesi i zhvillimit të Planit të Integritetit

Procesi i hartimit të Planit të Integritetit në Teatrin Kombëtar Eksperimental “Kujtim Spahivogli” konsistoi në zbatimin e fazave të mëposhtme:

1.1.1 Ngritja e grupit të punës për hartimin e Planit të Integritetit dhe mobilizimi i stafit

Titullari i institucionit ngriti grupin e punës për vlerësimin e riskut të integritetit dhe përgatitjen e Planit të Integritetit të TKEKS, me urdhër të posaçëm. Në përbërje të grupit të punës u përfshinë punonjës të institucionit të nivelit drejtues, përgjegjës sektorësh dhe specialistë të fushave përkatëse.

1.1.2 Identifikimi dhe analiza e riskut

Në këtë fazë, Grupi i Punës i kushtoi vëmendje të veçantë analizës së kuadrit ligjor dhe rregullator të brendshëm që rregullon veprimtarinë e TKEKS. U zhvilluan takime dhe diskutime të brendshme, të cilat shërbyen për nxjerrjen e konkluzioneve dhe marrjen e vendimeve.

Mbështetur në Metodologjinë e Vlerësimit të Riskut të Integritetit për institucionet e qeverisjes qendrore, identifikimi i risqeve u realizua kryesisht në fushat e:

- a) menaxhimit financiar;
- b) burimeve njerëzore;
- c) transparencës dhe informimit;
- d) proceseve të tjera të veprimtarisë institucionale.

Gjithashtu, Grupi i Punës realizoi një anketim me punonjësit e TKEKS për të vlerësuar nivelin e njohurive mbi kuadrin rregullator institucional dhe për të matur perceptimet lidhur me integritetin profesional dhe korrupsionin.

1.1.3 Vlerësimi i risqeve të integritetit

Në këtë fazë u vlerësua intensiteti i risqeve të identifikuara dhe u analizuan faktorët që mund të ndikojnë në rritjen ose mbështetjen e tyre. U krye gjithashtu një analizë më e detajuar për fushat e veprimtarisë që paraqesin ekspozim më të lartë ndaj risqeve të integritetit.

Procesi u pasurua nga diskutimet dhe feedback-u i marrë gjatë takimeve të zhvilluara nga Grupi i Punës.

1.1.4 Plani i Veprimit për Menaxhimin e Riskut

Grupi i Punës hartoi Planin e Veprimit për menaxhimin e risqeve të integritetit në institucion. Masat e parashikuara përshkruajnë aktivitetet që duhet të zbatohen për zvogëlimin ose eliminimin e risqeve të integritetit, afatet kohore dhe përgjegjësitë organizative për zbatimin e tyre.

Zbatimi i këtij Plani Integriteti është parashikuar për periudhën **2026–2030**.

1.2 Qasja metodologjike

Për procesin e vlerësimit të riskut të integritetit në TKEKS u përdorën dy metoda:

1. Metoda cilësore, përmes zhvillimit të takimeve me stafin e institucionit, me qëllim identifikimin e proceseve të punës të ekspozuara ndaj shkeljeve të integritetit, sjelljeve joetike ose joprofesionale. Ky proces u shoqërua me analizën e kuadrit rregullator të brendshëm të institucionit.

2. Metoda sasiore, përmes një ankete të strukturuar, ku punonjësit e institucionit u përgjigjën pyetjeve mbi çështje të integritetit dhe etikës. Anketimi përfshiu një kampion prej 21 punonjësish, me nivel besueshmërie statistikore 95% dhe shkallë gabimi $\pm 2\%$. Pyetësorët u plotësuan në mënyrë anonime dhe u administruan nga Grupi i Punës.

1.3 Përmbajtja e Planit të Integritetit

Plani i Integritetit përfshin:

- Deklaratën e Integritetit Institucional – shprehja e vullnetit dhe përkushtimit për integritet nga ana e titullarit të institucionit;
- Prezantimin e procesit të hartimit të Planit të Integritetit të TKEKS dhe qasjen metodologjike;
- Identifikimin e risqeve të integritetit dhe faktorëve të tyre sipas fushave të veprimtarisë;
- Planin e Veprimit, që përmban masat konkrete për adresimin e risqeve.

Plani i Integritetit dhe Plani i Veprimit janë vënë në dispozicion të gjithë stafit të TKEKS, duke shërbyer si dokument orientues dhe instrument praktik për forcimin e integritetit, profesionalizmit dhe performancës institucionale.

I. RISQET DHE FAKTORËT E RISQEVE TË INTEGRITETIT

Në këtë seksion paraqitet një përshkrim i përmblendhur i risqeve të integritetit dhe faktorëve të tyre, të analizuar sipas fushave të veprimtarisë së **Teatrit Kombëtar Eksperimental “Kujtim Spahivogli” (TKEKS)** dhe të kategorizuar si më poshtë:

1.1 Riske dhe faktorë të risqeve të lidhura me mjedisin e brendshëm rregullator dhe institucional për integritetin dhe luftën kundër korrupsionit

Teatri Kombëtar Eksperimental “Kujtim Spahivogli” ka hartuar dhe miratuar një sërë dokumentesh të brendshme institucionale që lidhen me integritetin, si Rregullorja e Brendshme, Kodi i Etikës dhe rregullat për parandalimin e konfliktit të interesit. Megjithatë, nga analiza e

kuadrit rregullator rezulton se disa aspekte të rëndësishme të integritetit kërkojnë përmirësim dhe plotësim të mëtejshëm.

Konkretisht, nevojitet rregullim më i qartë dhe i detajuar për:

- procesin e deklarimit dhe pranimin të dhuratave, përfitimeve të tjera të ngjashme dhe shpenzimeve të mbuluara nga palë të treta;
- pranimin e donacioneve dhe sponsorizimeve dhe administrimin e regjistrave përkatës;
- deklarimin e takimeve të zyrtarëve të institucionit me grupe interesi;
- ushtrimin dhe deklarimin e veprimtarive të jashtme të punonjësve;
- standardet e sjelljes së punonjësve pas përfundimit të marrëdhënies së punës (pas-punësimi).

Nga anketimi i zhvilluar me stafin rezultoi se shumica e punonjësve kanë dijeni për Kodin e Etikës në institucion, ndërsa një pjesë e tyre janë vetëm pjesërisht të informuar mbi përmbajtjen dhe zbatimin e tij. Kjo situatë tregon nevojën për rishikimin, përditësimin dhe konsolidimin e Kodit të Etikës, duke përfshirë në mënyrë të plotë rregullat që lidhen me etikën, integritetin, konfliktin e interesit, dhuratat, sponsorizimet, përdorimin e pasurisë dhe burimeve publike, si dhe veprimtaritë e jashtme të punonjësve.

Rregullorja e Brendshme e TKEKS duhet të reflektojë qartë:

- strukturën organizative dhe funksionet e brendshme;
- njësitë dhe funksionet që rrjedhin nga legjislacioni për të drejtën e informimit, konsultimin publik, sinjalizimin dhe parandalimin e konfliktit të interesit;
- linjat e komunikimit dhe raportimit ndërmjet njësive organizative;
- procedurat e bashkëpunimit me institucionet e varësisë;
- rregullat për këshillimin me publikun dhe paraqitjen e nismave qytetare;
- procedurat për mbrojtjen e të dhënave personale dhe garantimin e të drejtës së informimit në kohë reale.

Gjithashtu, vlerësohet e nevojshme që Rregullorja të parashikojë procedura të qarta për dorëzimin e detyrave në rastet e largimit të punonjësve nga institucioni, transferimit ndërmjet njësive apo ndryshimit të përgjegjësisë.

Nga shqyrtimi i kuadrit rregullator rezulton se nuk janë plotësuar ende rregulla të detajuara për regjistrimin, hetimin dhe shqyrtimin e sinjalizimeve për veprime ose praktika të dyshuara korruptive, në përputhje me legjislacionin në fuqi për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve. Institucioni nuk ka ende të ngritur njësinë përkatëse për sinjalizimin dhe parandalimin e konfliktit të interesit, si dhe regjistrat përkatës. Megjithatë, deri më tani nuk janë evidentuar raste të regjistruara të konfliktit të interesit.

Po ashtu, TKEKS nuk ka miratuar ende rregulla të brendshme për funksionimin dhe administrimin e regjistrat të dhuratave, si dhe për deklarimin, origjinën dhe kontrollin e dhuratave të marra nga punonjësit.

Dokumente të tjera rregullatore që kërkojnë përmirësim janë politikat për privatësinë dhe mbrojtjen e të dhënave personale, të cilat duhet të përcaktojnë qartë mënyrën e mbledhjes,

përpunimit dhe ruajtjes së të dhënave personale të punonjësve dhe subjekteve që kanë marrëdhënie kontraktuale me institucionin.

Sfida kryesore të identifikuar në këtë fushë janë:

- nevoja për plotësimin dhe përditësimin e kuadrit rregullator të integritetit me rregulla dhe procedura të qarta antikorrupsion;
- forcimi i mekanizmave të brendshëm për menaxhimin e çështjeve të integritetit dhe rritja e njohurive të stafit.

1.2 Riske dhe faktorë të risqeve të lidhura me burimet njerëzore

Menaxhimi i burimeve njerëzore përbën një fushë me rëndësi të veçantë për integritetin institucional. Risqet lidhen me proceset e rekrutimit, promovimit, largimit nga detyra, menaxhimin e kontratave të punës, ndryshimet në strukturë dhe hartimin e akteve të brendshme që ndikojnë drejtpërdrejt në performancën dhe integritetin e institucionit.

Mirëfunksionimi i administratës së TKEKS kërkon linja të qarta hierarkike, manuale të proceseve të punës për çdo njësi, plane vjetore pune dhe promovimin e standardeve të administratës publike, elemente që kontribuojnë në ndërtimin e një kulture të qëndrueshme integriteti.

Institucioni përballë me vështirësi në sigurimin e profileve teknike të specializuara, si teknik ndriçimi, teknik skene, apo fonistë, fusha këto që kërkojnë trajnim të vazhdueshëm profesional. Mungesa e programeve të specializuara të trajnimit në nivel kombëtar e bën edhe më të domosdoshëm investimin në kualifikimin e stafit ekzistues.

Sfida kryesore në këtë fushë janë:

- Rregullim i ulët normativ i proceseve të punës, mungesë informacioni rreth proceseve dhe procedurave.
- Sesione trajnimi bazikë dhe të vazhdueshëm, për stafin punonjës të TKEKS, për çështje të integritetit dhe luftës kundër korrupsionit.
- Infrastrukturë fizike dhe pajisje të pamjaftueshme, mbingarkesë stafi në zyra.

1.3 Riske dhe faktorë të risqeve për transparencën dhe marrëdhëniet me publikun

Nga analiza e faqes zyrtare të internetit të TKEKS rezulton se publikohen rregullisht informacione me karakter njoftues dhe komunikues. Koordinatorin për të Drejtën e Informimit është caktuar me akt të titullarit dhe të dhënat e tij janë publikuar.

Megjithatë, menaxhimi efektiv i informacionit kërkon përditësim të vazhdueshëm të përmbajtjes, staf të trajnuar dhe respektim rigoroz të afateve ligjore për dhënien e informacionit. Institucioni ka hasur vështirësi teknike në menaxhimin e faqes së internetit, por janë ndërmarrë masa për normalizimin e funksionimit të saj.

Sfida kryesore në këtë fushë janë:

- përditësimi i rregullt i informacionit publik;
- përmirësimi i aksesit dhe linkimit të Programit të Transparencës.

II. PLANI I VEPRIMIT

Plani i Veprimit përfshin tërësinë e masave konkrete që synojnë adresimin e risqeve dhe faktorëve të risqeve të integritetit të identifikuar sipas fushave të përgjegjësisë dhe veprimtarisë së **Teatrit Kombëtar Eksperimental "Kujtim Spahivogli" (TKEKS)**. Ky plan përbën një instrument plotësues të politikave institucionale dhe të kuadrit rregullator në fuqi, me qëllim përmirësimin dhe forcimin e integritetit institucional, parandalimin e korrupsionit dhe rritjen e besimit të publikut.

Plani i Veprimit ka për qëllim arritjen e objektivave kryesore si më poshtë:

1. **Forcimi i kuadrit rregullator të integritetit dhe i instrumenteve për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit**, përmes përditësimit të akteve të brendshme, rregulloreve dhe procedurave përkatëse.
2. **Përmirësimi i menaxhimit të burimeve njerëzore**, rritja e kualifikimit profesional dhe forcimi i kapaciteteve të stafit, nëpërmjet trajnimeve të vazhdueshme dhe standardizimit të proceseve të punës.
3. **Rritja e transparencës institucionale dhe e llogaridhënies**, si dhe forcimi i partneritetit me grupet e interesit dhe publikun e gjerë, në përputhje me legjislacionin për të drejtën e informimit dhe konsultimin publik.

Plani i Veprimit shërben si dokument udhëzues për njësitë dhe punonjësit përgjegjës, duke përcaktuar masa konkrete, afate kohore, përgjegjësi institucionale dhe indikatorë për matjen e progresit.

2.1 Monitorimi dhe raportimi i Planit të Veprimit

Monitorimi i Planit të Veprimit realizohet në mënyrë periodike dhe përfshin kryerjen e aktiviteteve nga ana e punonjësve dhe/ose grupeve të punonjësve përgjegjës për zbatimin e masave të miratuara. Procesi i monitorimit synon të vlerësojë nëse masat e ndërmarra kanë qenë efektive, nëse kanë ndikuar në uljen e risqeve të identifikuar dhe nëse janë shfaqur ndryshime në kontekstin institucional që kërkojnë rishikim të masave ekzistuese apo të prioriteteve të Planit të Veprimit.

Monitorimi shërben gjithashtu për nxjerrjen e mësimave dhe rekomandimeve për përmirësimin e planifikimit dhe zbatimit të masave në të ardhmen.

Raportimi është një procedurë e rregullt dhe e strukturuar, e cila siguron ndjekjen dhe zbatimin e Planit të Integritetit brenda afateve kohore të parashikuara. Ky proces koordinohet nga personi ose njësia përgjegjëse e caktuar me urdhër të titullarit të institucionit, e cila ndjek progresin e zbatimit dhe përgatit raportet përkatëse të monitorimit.

Raporti i monitorimit, pas miratimit nga titullari i institucionit, bëhet publik dhe vihet në dispozicion të publikut në faqen zyrtare të internetit të TKEKS, duke garantuar transparencë dhe llogaridhënie institucionale. Raportimi i mundëson titullarit të ndërmarrë masa korrigjuese dhe përmirësuese në rastet kur zbatimi i masave të caktuara ka hasur vështirësi, vonesa apo nevojë për rishikim.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

GJERGJI PREVAZI

Adresa: Rr. "Sami Frashëri", Tiranë, Shqipëri,
www.tkeks.gov.al

